

RAPORTI TEKNIK



OBJEKTI:

***“PËRGATITJA E PROJEKT PREVENTIVIT PËR
RIKONSTRUKSIONIN E GODINËS SË KORPUSIT QËNDROR
DHE SISTEMIMIN E AMBJENTEVE TË JASHTME TË SUT”***

POROSITES:

SPITALI UNIVERSITAR I TRAUMES

PROJEKTUES:

BOE “CIVIL CONS” Sh.p.k & "C.E.C Group" Sh.p.k

2022

PERMBAJTJA

1	INFORMACION I PERGJITHSHEM	3
1.1	Pershkrimi i pergjithshem	3
1.1.1	Objektivi i Përgjithshëm	3
1.1.2	Objektiva Specifike	4
1.2	Analizë e gjendjes ekzistuese	5
1.2.1	Pozicioni gjeografik	5
1.2.2	Foto te Gjendjes Aktuale	6
1.2.3	Strategjia e ndërhyrjes	9
1.2.4	Punime civile	9
	ARKITEKTURA	10
2.1	Gjendja ekzistuese	10
2.2	Pershtatja	12
2.3	Akseset, flukset e lëvizjes dhe daljet e emergjencave	14
2.3.1	Analiza e përgjithshme e flukseve	14
2.3.2	Aksesi i godinës dhe daljet e emergjencës	14
2.3.4	Lëvizja/Qarkullimi brenda spitalit	15
2.3.5	Organizimi funksional	16
2.3.5.1	Bloku 1	16
2.3.5.2	Bloku 2	19
2.3.5.3	Bloku 3	21
2.3.5.3	Bloku 4	24
2.3.5.3	Bloku 5	27
2.3.6	Koncepti I design në fasadë dhe materialet	29

1 INFORMACION I PERGJITHSHEM

Vendodhja:Rruga “Lord Bajron” , Laprake, Tirane.

1.1 Pershkrimi i pergjithshem

Spitali Universitar i Traumës është institucion kombëtar shëndetësor i Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë që siguron ndihmën mjekësore të specializuar për efektivat e Forcave të Armatosura (FA), të strukturave që parashikon statusin e ushtarakut dhe për popullsinë civile, për problemet e politraumës. Ai është i pozicionuar në pjesën veri-perëndimore të Tiranës. Objekt i detyrës së projektit është rikonstruksioni i Godinës trekatëshe (semundjet e brendshme) dhe ndërtimin e urës lidhëse me Korpusin qendror. Sipas planit të rikonstruksionit të godinës, me financim nga buxheti i shtetit, është parashikuar një rikonstruksion i ambienteve duke e kthyer në ambiente të përshtatshme me një funksionim normal dhe dinjitoz dhe me standardet më të mira ndërkombëtare për këtë tip godine të Spitalit Universitar të Traumës.

1.1.1 Objektivi i Përgjithshëm

Qëllimi i Projektit është përmirësimi dhe rritja e kapaciteteve të shtrimit dhe të shërbimit ambulator pranë Pavionit të Sëmundjeve të Brendshme pranë SUT, rritjes së eficiencës së kujdesit shëndetësor, përmirësimin e menaxhimit të informacionit në sistemin shëndetësor dhe rritjen e aksesit financiar të shërbimeve shëndetësore. Shërbimet që përfshin ky projekt janë:

- Riorganizimi funksional i godinës ekzistuese me qëllim optimizimin e shfrytëzimit të hapësirave të brendshme
- Realizimi i shtesës anësore me qëllim rritjen e kapaciteteve
- Përmirësimi i infrastrukturës spitalore
- Rikonstruksion, rinovim dhe rimobilim me qëllim modernizimin dhe përmirësimin e shërbimeve që do të ofrohen

Përzgjedhja e projekteve dhe e impianteve mekanike është bazuar në aplikimin dhe projektimin e sistemeve teknologjike përkatëse me një efikasitet maksimal për të realizuar zgjidhje bashkohore teknike mbi bazë të normave dhe kushteve teknike europiane, me vlera minimale të kostove të investimit mbi bazë të fondeve në dispozicion, si dhe në respekt të kërkesave të parashtruara të termave të referencës në detyrën e projektit.

Në vijim, në mënyrë të përmbledhur përshkruajmë kriteret të cilat janë marrë parasysh gjatë projektimit si referencë esenciale për kualifikimin e zgjidhjeve impiantistike mekanike:

- Respektim i normave teknike
- Komfort shërbimi,
- Besueshmëri funksionale,
- Inspektueshmëri,
- Higjenë dhe siguri,
- Parcializim përdorimi,
- Kosto të ulët energjistik përdorimi,
- Kosto të ulët të investimit fillestar,
- Kosto të ulët të mirëmbajtjes,
- Standartizim të komponentëve impiantistikë,
- Respektim maksimal të kushteve ekologjike dhe mjedisore,

Në përgjithësi mund të themi që projektet mekanike janë mbështetur konform normave respektive europiane.

Ne hartimin e projekteve të impianteve mekanike, jemi mbështetur gjithashtu në baze të Kategorizimit të këtij spitali, mbi baze të Strukturës dhe shërbimeve mjeksore të parashikuara në Detyrën e Projektimit, mbi baze të Konstatimeve dhe vlerësimeve të gjendjes ekzistuese të impianteve Mekanike dhe mbi baze të Propozimeve të zgjidhjeve Arkitektonike, Konstruktive dhe Mjeksore.

1.1.2 Objektiva Specifike

Objektivi i përgjithshëm i projektit është përmirësimi dhe rinovimi i godinës kryesore ekzistuese të Godinës së Pavionit të Sëmundjeve të Brendshme dhe Ambulatorëve të tij.

Me qëllim rritjen e kapaciteteve, përmirësimin dhe modernizimin e shërbimeve, struktura ekzistuese do t'i nënshtrohet:

- rikonstruksionit total
- ndërtimit të një shtese

Sa më sipër, do të bëhet studimi dhe vlerësimi i ndërtesës ekzistuese si dhe hartimi i projekteve arkitektonike dhe inxhinierike; përlllogaritja e kostove; raportet teknike.


1.2 Analizë e gjendjes ekzistuese

1.2.1 Pozicioni gjeografik

Tirana, si kryeqytet i Shqipërisë, është qendra kryesore shoqërore, politike, ekonomike, social-kulturore, shëndetsore e vendit. Gjeografikisht ajo pozicionohet në pjesën qendrore të Shqipërisë. Në një distancë prej rreth 25km në drejtimin perëndimor ndodhet Aeroporti “Nënë Tereza” (i vetmi aeroport civil në vend) dhe në distancë prej rreth 35km, në po të njëjtin drejtim, ndodhet Porti i Durrësit (porti më i madh në vend).

Shërbimet shëndetësore publike spitalore në këtë qytet deri tani janë marrë kryesisht përmes QSUT si edhe SUT. Projekti i Spitalit Universitar të Traumës përfshin shfrytëzimin e infrastrukturës ekzistuese duke e adaptuar për nevojat e reja dhe duke shtuar infrastrukturë të re në mënyrë që të përmbushen kërkesat për një spital me standarde të larta. Ky Spital do t’i shërbejë qytetit të Tiranës në mënyrë që shërbimet e nivelit sekondar të mund të merren në afërsi.

Spitali Universitar i Traumës pozicionohet në pjesën veriperëndimore të qytetit të Tiranës, konkretisht në një distancë prej rreth 2.3km larg qendrës së Tiranës.




Pozicionimi i SUT-së në raport me qytetin e Tiranës

1.2.2 Foto te Gjendjes Aktuale

Më poshtë gjenden foto të gjendjes ekzistuese.







1.2.3 Strategjia e ndërhyrjes

Parimet bazë të ndërhyrjes me qëllim realizimin e objektivëve, janë renditur më poshtë:

- Rikonstruksion tërësor, I brendshëm, I jashtëm dhe I sistemeve të jashtme; rinovim me qëllim modernizimin dhe përmirësimin e shërbimeve që do të ofrohen
- Riorganizimi funksional i godinës ekzistuese me qëllim optimizimin e shfrytëzimit të hapësirave të brendshme
- Realizimi i shtesave anësore me qëllim rritjen e kapaciteteve
- Përmirësimi i infrastrukturës spitalore

1.2.4 Punime civile

Në aspektin arkitektonik, rikonstruksioni tërësor nevojitet të kryhet në mënyrë që kushtet fizike standardet e projektimit dhe ndërtimit të jenë conform standardeve bashkëkohore. Rikonstruksioni I ambienteve do të jetë një ndërhyrje, që në bazë të tij do të ketë nga njëra anë shtimin dhe riorganizimin e hapësirave dhe nga ana tjetër do të realizohen punime civile që rrisin komfortin dhe cilësinë e shërbimit spitalor.

Për këtë, ajo cka propozojmë të realizohet është:

- Veshje e fasadës me system kapot. Izolimi termik i fasadës është me panele polisteroli me spesor 5cm dhe 10cm.
- Ndërrim I vetratave të jashtme
- Ndërrim I dyerve të brendshme
- Prishje muresh dhe ndërtim muresh të reja me qëllim riorganizimin e hapësirave të brendshme. Ndërtimi I një shtese në lartësi, 1 kat, mbi objektin ekzistues 1 katësh.
- Ndërrim I shtresave të dyshemeve (kalim nga dysheme me me pllaka ne dysheme me pvc)
- Ndërrim I shtresave hidroizoluese dhe atyre veshëse në tualete dhe ndërrim I pajisjeve hidrosanitare
- Ndërrim I tavaneve të varur
- Lyerje të ambjenteve të brendshme dhe të fasadës
- Rikonstruksion I thellë I tarracës
- Përmirësimi I sistemeve të jashtme
- System I ri elektrik, mekanik, hidraulik, etj

ARKITEKTURA

2.1 Gjendja ekzistuese

Kompleksi i Spitalit të Universitar të Traumës është ndërtuar në disa faza dhe faza e parë ka përfunduar në vitin 1929 ku si fillim objekti është projektuar si godine befotrofi (shtëpi fëmijësh) e më tej është përshtatur në kompleks spitalor. Ky kompleks spitalor përfshin shume specialitete por pjesë e rikonstruksionit do të jetë Korpusi kryesor i kompleksit. Ky korpus përbëhet nga 5 blloqe/godina më funksione të ndryshme secila. Edhe vetë ky Korpus, edhe pse ndërtimi i pjesës kryesore të tij ka përfunduar në vitin 1929, përvec rikonstruksioneve të ndryshme pjesore që ka pësuar ndër vite, në këtë korpus janë ndërtuar dhe shtesa anësore me qëllim rritjen e kapaciteti të tij.


Funksioni_Godina përmban këto funksione kryesore te ndara në Blloqet përkatëse përkatëse:

Blloku 1: Ortopedi 1, Ortopedi 2, Kirurgji 2

Blloku 2: Reanimacion, Spitali Amerikan, Kirurgji 1

Blloku 3: Urgjenca, Blloku Operator, Spitali Amerikan, Ambjente teknike nentokë

Blloku 4: Radiologji, Reception, Facilitetet (Farmaci, Magazine, Mencë, Sallë leksionesh, etj)



Sipërfaqet e secilit Bllok dhe Pavion, jepen në tabelën e mëposhtme:

Blloku	Funksioni	Siperfaqe Ekzistuese				Total
		Kati -1	Kati 0	Kati +1	Kati +2	
Blloku 1	Ortopedi 1		840 m ²			840 m ²
	Ortopedi 2			840 m ²		840 m ²
	Ortopedi 3				840 m ²	840 m ²
Blloku 2	Reanimacion		901 m ²			901 m ²
	Kirurgji 1			901 m ²		901 m ²
	Kirurgji 2				901 m ²	901 m ²
Blloku 3	Ambjente teknike dhe shwrbimi	1,103 m ²				1,103 m ²
	Urgjenca		1,718 m ²			1,718 m ²
	Blloku Operator			1,800 m ²		1,800 m ²
	Korridor, etj				345 m ²	345 m ²
Blloku 4	Ambjente teknike dhe shwrbimi	320 m ²				320 m ²
	Facilitete		1,865 m ²			1,865 m ²
Blloku 5	Neurokirurgji			504 m ²		504 m ²
	ORL+Neurokirurgji			1,225 m ²		1,225 m ²
	Zyra			122 m ²		122 m ²
	Zyra				128 m ²	128 m ²
Total	Total	1,423 m²	5,324 m²	5,392 m²	2,214 m²	14,353 m²

Rifiniturat Rifiniturat e brendshme dhe të jashtme të godinës shfaqen në nivel të lartë amortizimi të ardhura këto jo vetëm për shkak të amortizimit fizik natyror që pësojnë strukturat dhe materialet por dhe për shkak të projektimeve të meparshme në nivele jo-optimale si në nivel projektues ashtu dhe zbatues në përdorimin e materialeve dhe instalimeve teknike dhe detajeve konstruktive. Sa më sipër, bazuar në inspektimin në vend problemet me evidente janë:

- Kushte jo të mira të mbështjellës së ndërtesës (fasadës). Përvec amortizimit evident ajo shfaq dhe nivel të lartë lagështie sidomos në nivelin e kateve nëntokë dhe përdhe duke bërë të deduktojmë që përvecse shtresat e përdorura janë jo rezistente ndaj lagështirës por mund të ketë dhe arsye të tjera që ndoshta mund lidhen me aspektin teknik të realizimit të hidroizolimit në themele.
- Mungesë izolimi termik si në muret perimetral prej guri ashtu dhe në muret perimetrale prej tull, ashtu dhe në vetrata të cilat nuk kanë veti termike dhe për më tepër montimi i tyre jo-optimal bënë që humbjet e energjise të jenë të larta
- Sistemime të jashtme që kanë nevojë për rishikim pasi aksesit për persona me aftësi të kufizuara nuk është i mundur nga çdo pikë aksesit në godinë. Gjithashtu përreth godinës terreni është i pasistemuar dhe nuk kanë një funksion të mirëfilltë me qëllim shfrytëzimin e tyre si hapësira recreative për pacientë dhe vizitorë.

- Flukset e njerëzve janë të paorganizuar dhe funksionojnë në mënyrë të pakontrolluar. Në hyrjen kryesore aksesojnë, pacientë për pavionin, pacientë për vizita ambulatorë në radiologji, vizitorë, staf mjekësor, staf I policies, materiale të pastra, materiale të papastra.
- Tualetet janë të papërshtatshme për përdorimin e tyre nga persona me aftësi të kufizuara. Edhe tualetet e pacientëve të cilat janë shtuar përgjatë viteve, kanë dimensione të papërshtatshme.
- Shtrimet e dyshemeve janë bërë me pllaka gres porcelanat pavarsisht se sipas standardeve duhen përdorur shtrimet me pvc
- Instalimet hidraulike, elektrike, mekanike, linjat e oksigjenit paraqiten të amortizuara. Në disa prej ambjenteve mungojnë linja oksigjeni.
- Amortizim I suvasë në zona të caktuara; amortizimi I tavaneve të gipsit, I dyerve, etj.
- Dhomat janë të mbipopulluara dhe 3-4 krevat për rreth 20m², pra 5-6.7m²/shtrat, kur sipas normativë nevojiten 9m² për shtrat. Për më tepër që instalimet janë bërë për 2 krevate.


2.2 Pershtatja

Në aspektin funksional, me qëllim standardizimin e kapaciteteve aktuale të cilat nuk janë sipas standardeve bashkëkohore, kemi realizuar këto ndërhyrje kryesore:

- Në Bllokun 1 dhe Bllokun 2 do të ndërtohen shtesa anësore 3 katëshe të cilat përvetsje do të rrisin sipërfaqen e shfrytëzueshme, do të ndihmojnë dhe në unifikimin e fasadave. Përmes tyre këmi berë të mundur që të realizojmë vendosje të shtretërv konform standardeve bashkëkohore si dhe të shtojmë ambjente që rrisin konfortin si për pacientët dhe për mjekët.
- Në Bllokun 2, në katin e parë teknik, ku aktualisht ushtron veprimtarinë Spitali Amerikan, është menduar të zhvillohet pavioni Kirurgji 1, duke bërë të mundur që të 3 katet e Bllokut 1, t'i dedikohen 3 pavioneve të Ortopedisë, ndryshe nga mënyra si funksionon tani ku këto 3 reparte pozicionohen në 2 kate.
- Në Bllokun 3, do të realizohet një shtesë anësore 1 katëshe e cila do të funksionojë si zonë pritje për vizitorët e pacientëve të urgjencës. Kjo zonë nuk do të ketë lidhje funksionale me pjesën tjetër të spitalit.
- Në Bllokun 4, magazina aktuale do të ndahet në 2 kate dhe do të rindërtohet mbulesa e saj. E gjithë kjo ndërhyrje do të kërkojë një ndërhyrje të thellë konstruktive. Kati përdhe i saj do vazhdojë te funksionojë si magazinë dhe një pjesë si farmaci ndërkohë që kati i pare do të funksionojë si nje pjesë e pavionit të Nurokirurgjisë.

- Blloku 5 do vazhdojë të funksionojë si repart shtrimi për ORL dhe Neurokirurgji duke i shtuar dhe katin e sipërm të Magazinës (sic është përmendur dhe më sipër).

Më poshtë paraqiten konvencionalisht shtesat që do të realizohen si dhe sipërfaqet e propozuara përfshirë shtesat.



Blloku	Funksioni	Sipërfaqe të propozuara				Total
		Kati -1	Kati 0	Kati +1	Kati +2	
Blloku 1	Ortopedi 1		1,023 m ²			1,023 m ²
	Ortopedi 2			1,023 m ²		1,023 m ²
	Ortopedi 3				1,023 m ²	1,023 m ²
Blloku 2	Reanimacion		1,062 m ²			1,062 m ²
	Kirurgji 1			1,062 m ²		1,062 m ²
	Kirurgji 2				1,062 m ²	1,062 m ²
Blloku 3	Ambjente teknike dhe shwrbimi	1,087 m ²				1,087 m ²
	Urgjenca		1,780 m ²			1,780 m ²
	Blloku Operator			1,800 m ²		1,800 m ²
Blloku 4	Korridor, etj				329 m ²	329 m ²
	Ambjente teknike dhe shwrbimi	320 m ²				320 m ²
	Facilitete		1,865 m ²			1,865 m ²
Blloku 5	Neurokirurgji			552 m ²		552 m ²
	ORL+Neurokirurgji			1,332 m ²		1,332 m ²
	Zyra			122 m ²		122 m ²
	Zyra				128 m ²	128 m ²
Total	Total	1,407 m²	5,730 m²	5,891 m²	2,542 m²	15,570 m²

2.3 Akseset, flukset e lëvizjes dhe daljet e emergjencave

2.3.1 Analiza e përgjithshme e flukseve


Transporti dhe komunikimi zënë një sasi të madhe të kohës gjatë orarit të punës së stafit mjekësor. Analiza e ndërveprimit mes sektorëve dhe nënsektorëve (zonave të brendshme brenda një sektori), përbën kushtin për t’u përballur në mënyrë të drejtë me impiantin e shpërndarjes në ndërtesë. Nga njohja e mirë e tyre dhe dhënia e zgjidhjeve të drejta varet eficientia dhe cilësia e shërbimit shëndetësor të ofruar.

Parimi bazë është diferencimi i rrugëkalimeve në funksion të kategorive ose materialeve që transportohen. Më poshtë gjendet një kategorizim i përgjithshëm i tyre dukë i ndarë në 2 kategori kryesore: Persona dhe Materiale.

Kategori	Nenkategori	Përshkrim
Persona	Stafi	Stafi Mjekësor
		Stafi Administrativ
	Pacientë të jashtëm dhe të brendshëm	Stafi Mbështetës
		Ambulantet Specialistike
Vizitorë	Repartet e Shtrimit	
	Vizitorë periodik	
	Vizitorë jo-periodik	
Materiale	Materiale të pastra	Ushqim
		Ilaçe
		Çarçafë
		Materiale Sterile
		Defergjente
		Pajisje
		Etj

Bazuar në analizën e flukseve të mësipërme, më poshtë gjendet analiza e akseseve në objekt.

2.3.2 Aksesi i godinës dhe daljet e emergjencës



Pas studimit të detajuar të kategorive kryesore të flukseve si dhe nënkategorive të tyre si dhe duke u bazuar në kontekstin urban dhe rrugor ku pozicionohet spitali aktual, hyrja në godinë undësohet përmes 6 pikave aksesi ekzistues dhe fluksi i lëvizjeve është llogaritur si më poshtë:

- Hyrja 1 për pacientë, staf dhe vizitorë
- Hyrja 2 për vizitorë të pacientëve të urgjencës
- Hyrja 3 për pacientë të urgjencës
- Hyrja 4 për kufoma dhe materiale të papastra
- Hyrja 5 për materiale të pastra si ushqime, medikamente, etj
- Hyrjet 6 për në zonat teknike
- Hyrja A, pozicionohet në katin e dytë dhe lidh pavionin korpusin kryesor të spitalit me GSB.

Në brendësi, objekti aksesohet dhe nga seksione të tjera si administrata, reparti i fizioterapise, atriumet e brendshme.

2.3.4 Lëvizja/Qarkullimi brenda spitalit

Sic është thënë dhe më sipër, qarkullimi dhe transporti zënë një pjesë të mirë të kohës së stafit gjatë orarit të punës. Organizimi i lëvizjes në mënyrë eficiente do të impaktonte drejtpërdrejtë dhe shërbimin shëndetësor ndaj pacientëve. Pozicioni i secilës vendndodhje dhe ndërlidhja mes tyre varet më së shumti nga rrejtja e flukseve, i cili përcaktohet nga:


- Intensiteti i flukseve
- Urgjenca e flukseve
- Delikatesa e disa lidhjeve (si psh lidhja mes materialeve sterile, trajektoreve të pastra e të papastra)

Më poshtë përshkruhen qarkullimet horizontale dhe vertikale që ofron zgjidhja e propozuar.

Qarkullimi horizontal midis zonave realizohet përmes korridoreve të bollshme, me gjerësi konform standardeve të projektimit, në varësi dhe të çfarë do të transportohet në secilin segment.

Këta korridore, janë organizuar në mënyrë të tillë që të lejojnë një qarkullim linear. Në vijim të korridorëve të godinës ekzistuese, në katin e 2-të teknik do të shtohet një urë lidhëse e cila do të lidhë Godinën e Sëmundjeve të Brendshme me objektin kryesor të SUT.

Qarkullimi vertikal midis kateve realizohet përmes korpuseve të shkallëve dhe ashensorëve ekzistues.




2.3.5 Organizimi funksional

Lidhur me organizimin funksional, sic është thënë dhe më sipër, objekti ndahet në 5 Blloqe. Secili nga blloqet përmabn pavionet përkatëse dhe më poshte do të bëhet një përshkrim I secilit prej tyre.

Lidhur me numrin e shtretërve me poshtë gjendet tabela e numrit ekzistues të tyre dhe tabela e numrit të propozuar të shtretërve.

Blloku	Funksioni	Sipërfaqe Ekzistuese	
		Nr. Shtreter ekzistues	Nr. Shtreter propozim
Blloku 1	Ortopedi 1	28 shtreter	30 shtreter
	Ortopedi 2	28 shtreter	26 shtreter
	Ortopedi 3	25 shtreter	27 shtreter
Blloku 2	Kirurgji 1	27 shtreter	27 shtreter
	Kirurgji 2	25 shtreter	27 shtreter
Blloku 4+5	Neurokirurgji	20 shtreter	37 shtreter
	ORL	15 shtreter	
Total	Total	168 shtreter	174 shtreter

2.3.5.1 Blloku 1



Në Bllokun 1 propozohen të zhvillohen këto Pavione:

1. Ortopedi 1 – 30 shtretër
2. Ortopedi 2 – 26 shtretër
3. Ortopedi 3 – 27 shtretër


Kati përdhe



Kati I parë

Blloku 1		
Kati 0	Kati 1	Kati 2
Dhomë Pacienti 1	Dhomë Pacienti 1	Dhomë Pacienti 1
Dhomë Pacienti 2	Dhomë Pacienti 2	Dhomë Pacienti 2
Dhomë Pacienti 3	Dhomë Pacienti 3	Dhomë Pacienti 3
Dhomë Pacienti 4	Dhomë Pacienti 4	Dhomë Pacienti 4
Dhomë Pacienti 5	Dhomë Pacienti 5	Dhomë Pacienti 5
Dhomë Pacienti 6	Dhomë Pacienti 6	Dhomë Pacienti 6
Dhomë Pacienti 7	Dhomë Pacienti 7	Dhomë Pacienti 7
Dhomë Pacienti 8	Dhomë Pacienti 8	Dhomë Pacienti 8
Dhomë Pacienti 9	Dhomë Pacienti 9	Dhomë Pacienti 9
Dhomë Pacienti 10	Dhomë Pacienti 10	Dhomë Pacienti 10
Dhomë Pacienti 11	Dhomë Pacienti 11	Dhomë Pacienti 11
Dhomë Pacienti 12	Dhomë Pacienti 12	Dhomë Pacienti 12
Dhomë Pacienti 13	Dhomë Pacienti 13	Dhomë Pacienti 13
Dhomë Pacienti 14	Shefi i Shërbimit	Shefi i Shërbimit
Shefi i Shërbimit	Dhomë Mjekësh 1	Dhomë Mjekësh 1
Dhomë Mjekësh 1	Dhomë Mjekësh 2	Dhomë Mjekësh 2
Dhomë Mjekësh 2	Dhomë Mjekësh 3	Dhome angiologu
Dhomë Mjekësh 3	Kryeinfemieria	Kryeinfemieria
Kryeinfemieria	Infemieria	Infemieria
Infemieria	Dhome gipsi	Dhome gipsi
Dhome gipsi	Dhome mjekimi	Dhome mjekimi
Dhome mjekimi	Kuzhine	Kuzhine
Kuzhine	Dh. Gatishmërie	Dh. Gatishmërie
Dh. Gatishmërie	Dhomë Sanitare	Dhomë Sanitare
Dhomë Sanitare	Dhomë te pastra	Dhomë te pastra
Dhomë te pastra	Dhomë te papastra	Dhomë te papastra
Dhomë te papastra	Tualet për stafin me garderobe	Tualet për stafin me garderobe
Tualet për stafin me garderobe	Tualet për vizitorët	Tualet për vizitorët
Tualet për vizitorët	Tualet për PAN	Tualet për PAN
Tualet për PAN		


2.3.5.2 Blloku 2



Në Bllokun 2 propozohen të zhvillohen këto Pavione:

1. Reanimacion – 24 shtretër (8 + 12 + 4)
2. Kirurgji 1 – 27 shtretër
3. Kirurgji 2 – 27 shtretër

Kati përdhe



Kati I parë




Kati I dytë



Në secilin kat ndodhen këto ambiente:

Blloku 2		
Kati 0	Kati 1	Kati 2
Sallë reanimacioni 1	Dhomë Pacienti 1	Dhomë Pacienti 1
Sallë reanimacioni 2	Dhomë Pacienti 2	Dhomë Pacienti 2
Dhome sub-intensive 1	Dhomë Pacienti 3	Dhomë Pacienti 3
Dhome sub-intensive 2	Dhomë Pacienti 4	Dhomë Pacienti 4
Dhome sub-intensive 3	Dhomë Pacienti 5	Dhomë Pacienti 5
Dhome sub-intensive 4	Dhomë Pacienti 6	Dhomë Pacienti 6
Dhomë pacienti 1	Dhomë Pacienti 7	Dhomë Pacienti 7
Dhomë pacienti 2	Dhomë Pacienti 8	Dhomë Pacienti 8
Dhome manipulimi	Dhomë Pacienti 9	Dhomë Pacienti 9
Shefi I Shërbimit	Dhomë Pacienti 10	Dhomë Pacienti 10
Dhome mjekësh 1	Dhomë Pacienti 11	Dhomë Pacienti 11
Dhome mjekësh 2	Dhomë Pacienti 12	Dhomë Pacienti 12
Kryeinfemieri	Dhomë Pacienti 13	Dhomë Pacienti 13
Infermiera	Dhomë Pacienti 14	Dhomë Pacienti 14
Sallë Pritje	Dhomë Pacienti 15	Dhomë Pacienti 15
Dhome sterilizimi	Shefi i Shërbimit	Shefi i Shërbimit
Dhome relaksi	Dhomë Mjekesh	Dhomë Mjekesh
Dhomë Sanitare	Dhomë Mjekesh	Dhomë Mjekesh
Dhome të pastra	Dhomë Mjekesh	Dhomë Mjekesh
Dhome të papastra	Kryeinfemiera	Kryeinfemiera
Tualete për stafin	Infermiera	Infermiera
Tualete për vizitorë	Dhome mjekimi	Dhome mjekimi
	Dhome mjekimi	Dhome mjekimi
	Dhome gatishmerie	Dhome gatishmerie
	Kuzhine	Kuzhine
	Depo	Depo
	Dhomë Sanitare	Dhomë Sanitare
	Dhomë te pastra	Dhomë te pastra
	Dhomë te papastra	Dhomë te papastra
	Tualet për stafin me garderobe	Tualet për stafin me garderobe
	Tualet për vizitorët	Tualet për vizitorët
	Tualet për PAN	Tualet për PAN


2.3.5.3 Blloku 3



Në Bllokun 4 do të vazhdojnë të jenë:


- Kati nëntokë_Sallë leksione, Ambjente tenike, Depo
- Kati përdhe_Radiologji, Reception, Facilitetet (Farmaci, Magazine, Mencë, Sallë leksionesh, etj)
- Kati i parë_Pavioni i Neurokirurgjisë

Kati nëntokë




Kati përdhe

Kati i parë



Bloku 4
Kati 1
Dhomë Pacienti 1
Dhomë Pacienti 2
Dhomë Pacienti 3
Dhomë Pacienti 4
Dhomë Pacienti 5
Dhomë Pacienti 6
Dhomë Pacienti 7
Dhomë Pacienti 8
Dhomë Pacienti 9
Dhomë Pacienti 10
Dhomë Pacienti 11
Dhomë Pacienti 12
Dhomë Pacienti 13
Dhomë Mjekesh
Kryeinfemieria
Infemieria

2.3.5.3 Blloku 5



Në Bllokun 4 do të vazhdojnë të jenë:


- Kati i parë_Pavionet ORL, Neurokirurgji
- Kati i dytë_Zyra
- Kati i tretë_Zyra

Kati i parë




Biloku 5
Kati 1
Dhomë Pacienti 1
Dhomë Pacienti 2
Dhomë Pacienti 3
Dhomë Pacienti 4
Dhomë Pacienti 5
Shefi i Shërbimit
Shefi i Shërbimit
Dhomë Mjekesh
Dhomë Mjekesh
Dhomë Mjekesh
Dhomë Mjekesh
Dhomë Mjekesh
Kabinet
Kabinet
Kabinet
Kabinet
Kryeinfiermiera
Infiermiera
Dhome mjekimi
Dhome gatishmerie
Dhome gatishmerie
Dhome gatishmerie
Kuzhine
Kuzhine
Dhomë te pastra
Dhomë te papastra
Tualet për stafin me garderobe
Tualet për vizitorët
Tualet për PAN

Kati I dytë



Kati I tretë



2.3.6 Koncepti I design në fasadë dhe materialet

Në lidhje me konceptin e fasadës është propozuar unifikimi i volumeve ekzistues (3 kat), në harmoni me shtesat e reja volumore të propozuar po (3 kate). Duke qënë se objekti ka në tërësi disa thyerje të cilat krijojnë hapësira të pashfrytëzueshme, atëherë janë pikërisht këto hapësira në të cilat është propozuar unifikimi I fasadës. Si rrjedhojë e faktit që programi i Detyrës së Projektimit është shumë i ngjeshur, është parë e arsyeshme edhe e mundur që godinat të lidhen me njëra-tjetrën apo me elemente të tjetër arkitektonik por duke bërë unifikimi i 4 “Blloqeve” kryesore me volume më kompakte siç janë:

- Volumet 3 katëshe në Bllokun 1 dhe 2
- Volumi 1 katësh në Bllokun 3 ai I (Urgjences), për hollin e pritjes së vizitorëve të pacientëve të urgjencës.
- Ndërhyrje në lartësi dhe unifikim në volumin e magazinës aktuale.

Në struktura të tilla kompakte, por mbi të gjitha në një objekt shëndetësor ku nevoja për dritë dhe ventilim natyral ndikon jo vetëm në cilësinë e të përjetuarit të ambienteve, por dhe higjienën e spitalit e për pasojë edhe në shëndetin e pacientit, një vëmendje e vecantë I është dhënë atriumit të brendshëm, duke ndërhyrë në sistemimin e tij dhe në fasadat e brendëshme. Krijimi i këtij shërben mbi të gjitha për ndriçimin ambienteve të punës së stafit mjekësor në katet e sipërme. Hapësira e oborrit të brendshëm shërben edhe për ndriçimin e ambienteve nëntokë çarjet në tavan të cilave mundësojnë ndriçimin natyral e në rast nevojë edhe të ventilimit natyral.

- Lidhur me unifikimin e kësaj strukture në altimetri, ky unifikim realizohet edhe përmes materialeve dhe ngjyrave të përdorura që janë tonalitete e nuancave gri, materiale të cilat përfshijnë në mënyrë të vazhduar si objektin ekzistues ashtu dhe volumet e reja. Ajo që synojmë të bëjmë nuk është ‘zhdukja’ e objektit ekzistues dhe

imponimi i një objekti të ri që do shuante nga memoria objektin e mëparshëm, por bashkimi i të dyve, i dy mënyra të ndryshme projekimi, i dy mënyra të ndryshme konceptimi dhe perceptimi i hapësirave, i dy mënyrave të ndryshme të shfrytëzimit të sipërfaqeve. Pra, nga njëra anë synohet bashkimi simbiotik mes këtyre strukturave si funksionalisht ashtu dhe estetikisht, por nga ana tjetër lejojmë të dallohen diferencat mes objekteve ku harkada kryesore e hyrjes së objektit dhe adminitrsta, janë propozuar të rivishen me travertinë, gjithashtu po kjo rifiniturë është propozuar të përdoret ne korpuset e shkallëve dhe në hyrjen e re të vizitorëve të pacientëve të urgjencës.

- Lidhur me materialet që do të përdoren, muret perimetrale do të jenë të sistemit ‘kapot’ më veshje me lesh guri mbi murin actual të gurit, ose me veshje me lesh guri mbi murin e tullës në volume e reja, ndërkohë të ruhen ekuilibrat termik duke minimizuar kostot. Për të theksuar ritmin e fasadës aktuale dhe për të evidentuar gjurmët e arkitekturës Italian të viteve 30’ janë propozuar gjithashtu mbi këtë veshje me termoizolim, element vertikal në formën e nervaturave me gjerësi 60 cm secila dhe lartësi e cila përshkon të gjithë altimetrinë e objektit. Propozimi modular I këtyre nervaturave në fasadë, nuk bën gjë tjetër vecse thekson ritmin aktual që kanë dritaret e fasadave ekzistuese. Këto nervatura propozohen të realizohen me gips dhe trajtim me rifiniturë me suva grafiato pa strukturë sipas kodeve përkatëse. Dimensionet e dritareve janë ruajtur konform standardit duke mbajtur dimensionet ekzistuese në pjesën më të madhe të fasadës. Mbulimi I objektit propozohet të bëhet sërish me cati, por duke zëvendësuar shtresën e sipërme të saj e duke ruajtur strukturën e kapriatave ekzistuese dhe përmirësuar atë sipas rastit. Një pjesë e tarracave do të përdoret për vendosjen e pajisjeve të kondicionimit. Gjithashtu propozohet edhe një ndërhyrje në strehën e hyrjes së Bllokut 3 (Urgjencës). Ky element kërkon ndërhyrje për ta theksuar më shumë dhe për ta lidhur në mënyrë më bashkëkohore arkitekturën në këtë pjesë të fasadës, me tërësinë e objektit. Mbi soletën e hyrjes ekzistuese është eliminuar ballkoni, I cili nuk përcjell një vlerë arkitektonike në hyrjen e një objekti me rëndësi të tillë. Janë propozuar ngjyra të theksuara në këtë zonë, për ta evidentuar edhe me shumë si pjesë kaq kryesore të Spitalit të Traumës.